

THIRRJE PËR PARASHTRIMIN E OFERTËS (THPO) Punë ndertimore

Shteti: Republika e Maqedonisë së Veriut

Emri i projektit: Projekti i efikasitetit energjetik në sektorin publik

Emërtimi i marrëveshjes: Rikonstruimi i 6 (gjashtë) institucioneve shëndetësore publike me masa për rritjen e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nr. i huasë: 9038-MK

Nr. identifikimi i THPO: MK-MOF-CW-NCB-004-23

1. Republika e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme "Huamarrësi") siguroi mjete nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) ("Banka") në formën e huasë (në tekstin e mëtejme "hua") për shpenzimet e Projektit të efikasitetit energjetik në sektorin publik (në tekstin e mëtejme: PEESP) dhe synon t'i shfrytëzojë një pjesë të mjeteve të pranuar për pagesa sipas marrëveshjes së rikonstruimit të 6 (gjashtë) institucioneve shëndetësore publike me masat për rritjen e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2. Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut u bën thirrje ofertuesve të pranueshëm dhe të kualifikuar që të dorëzojnë oferta të mbyllura për punët ndërtimore që përfshijnë rikonstruimin e 6 (gjashtë) institucioneve shëndetësore publike me masa për rritjen e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut ku punimet ndërtimore do të kryhen sipas projekteve të përgatitura bazë dhe lejeve për rikonstruimin e institucioneve shëndetësore të mëposhtme:

- ISHP "Shtëpia e Shëndetit Resnjë"
- ISHP "Shtëpia e Shëndetit Demir Hisar"
- ISHP Shtëpia e Shëndetit "Prim. Dr. Gjorgji Gavrilski "Shën Nikollë - Ambulanca Lozovë"
- ISHP "Spitali i përgjithshëm me aktivitet të zgjeruar Dibër"
- ISHP "Shtëpia e Shëndetit Negotinë - Qendra Shëndetësore Demir Kapi"
- ISHP "Shtëpia e Shëndetit Negotinë – Qendra Shëndetësore Dolni Disan"

Punët ndërtimore për 6 (gjashtë) institucionet shëndetësore publike të theksuara më sipër duhet të përfundojnë në afat prej 10 (dhjetë) muajve nga data e fillimit të punës. Kriteret e kualifikimit/përzgjedhjes përcaktohen në dokumentacionin e tenderit në Segmentin III, Kriteret e evaluimit dhe kualifikimit.

3. Dorëzimi i ofertave do të kryhet nëpërmjet procedurave nacionale të ankandit konkurrues duke shfrytëzuar Thirrje për parashtrimin e ofertës (THPP) siç është theksuar në Rregulloren e Prokurimeve të Bankës Botërore për huamarrësit për financimin e projekteve investuese, prokurimet për financimin e projekteve investuese, mallrat, punët, shërbimet jokonsulente dhe konsulente nga korriku 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe gusht 2018 (Rregulloret e prokurimeve) dhe është e hapur për të gjithë Ofertuesit siç përcaktohet në Rregulloren e prokurimeve.

4. Ofertuesit e interesuar mund të marrin informacione shtesë nga Njësia e Implementimit të Projektit e cila është përgjegjëse për zbatimin e Projektit të efikasitetit energjetik në sektorin publik (në tekstin e mëtejme "NJIP") në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga znj.

Tatjana Veličković, e-mail: tatjana.velichkovik@finance.gov.mk,
dhe ta kontrollojnë dokumentacionin e tenderit gjatë orarit të punës, në periudhën prej 09:30 - 15:30
në adresën rr. Dame Gruev, nr.12, 1000 Shkup.

5. Ofertuesit e interesuar të kualifikuar mund ta marrin dokumentacionin e tenderit në gjuhën maqedonase nga ueb-faqja e Sistemit Elektronik Nacional për Prokurim Publik: "SEPP-Hua/Donacione/Grante - Shpallje nga institucionet ndërkombëtare" (<https://www.e-nabavki.gov.mk/>), nga uebfaqja e Ministrisë së Financave: https://finance.gov.mk/proekt_za_energetska_efikasnost/, si dhe me parashtrimin e kërkesës në adresën elektronike të theksuar më lartë në pikën nr.4.

6. Të gjithë ofertuesit e kualifikuar të interesuar duhet të regjistrohen me e-mail me detajet kontaktuese të kompanisë së tyre, duke përfshirë e-mailin menjëherë pas shkarkimit të dokumentacionit të tenderit nga faqet e mësipërme të internetit, në mënyrë që të deklarojnë se synojnë të marrin pjesë në procedurën e tenderit dhe ta marrin Aneksin 1 të dokumentacionit të tenderit i cili përmban: të gjithë dokumentacionin e tenderit, tabelën përlllogaritëse, projektin bazë, duke përfshirë përshkrimin teknik dhe vizatimet për çdo objekt si dhe kushtet e çështjeve të mjedisit jetësor dhe çështjeve sociale. Për shkak të vëllimit të Aneksit 1, ai do t'u dorëzohet ofertuesve që aplikuan në memorie USB.

7. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën rr. "Dame Gruev" nr. 12, 1000 Shkup, deri në datë 09.10.2023, në orën 13:00 me orën lokale. Ankandi elektronik nuk lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Hapja e ofertave do të jetë publike në prani të përfaqësuesve të autorizuar të ofertuesve dhe secili që do përzgjidhet duhet të marrë pjesë në adresën rr. "Dame Gruev" nr.12, 1000 Shkup më datë 09.10.2023, në orën 13:15 me orën lokale.

8. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me garancinë e ofertës në vlerë prej 3.500.000,00 denarëve.

9. Adresa e përmendur më sipër është:

Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Projekti i efikasitetit energjetik në sektorin publik, PEESP, Arkivi

Emërtimi i marrëveshjes: Rikonstruimi i 6 (gjashtë) institucioneve shëndetësore publike me masa për rritjen e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nr. identifikimi i THPO: MK-MOF-CW-NCB-004-23

Për: znj. Tatjana Veličković rr. Dame Gruev, nr. 12, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Numri i katit/zyrës: 7/18